REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 397-409/22
Datës/Datum. 15.09.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Agim Sheqiri-Ekspert Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit 06.09.2022	Data e dorëzimit të raportit 15.09.2022	Nr. lëndës: 397;409/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Më datën: 26 dhe 29 gusht 2022 OE. "Pharma Leader" LLC dhe OE. "Meditech" kanë parashtruar ankesë me numër: 397 dhe 409/22, për aktivitetin prokurimit me titull "Furnizim me Insulina analoge nga Lista Esenciale" Lot 1 dhe 3, me nr. te prokurimit: 206- 20-8397-1-1-1të realizuar nga Ministria e Shëndetësisë

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, kontratë për furnizim dhe vlera e parashikuar për Lot 1 1,239,245.44 Euro , ndërsa për Lot 3 vlera e parashikuar ka qenë 4,851,824.16 Euro

- Njoftimi për kontratë është publikuar me date 12.12.2020 , ndërsa hapja publike është bere me date 05.01.2021
- Publikimi i vendimit për rekomandim është bërë me datë 22.02.2021, dhe për kontratë për llot I dhe III rekomandohet OE "Pharma Leader" LLC me çmim prej 1,097,467.36 Euro per Lot I dhe 4,109,006.12 Euro për Lot III
- Kërkesa e parë për rishqyrtim nga OE Meditech"parashtrohet me datë 26.02.2022 dhe sipas vendimi të datës 01.03.2021 ankesa aprovohet si e bazuar dhe AK sipas vendimi te datës 05.03.20221 për kontrata rekomandon OE "Meditech me çmim prej 1,114,726.72 për lot I dhe 4,456,908.24 Euro për Lot III
- OE"Pharam Leader"LLC me date 10.03.2021 parashtron kërkesë për rishqyrtimit e cila nga ana e Autoritetit Kontraktues konsiderohet si e pa bazuar dhe si rezultat i refuzimi te kërkesës për rishqyrtim me datë 15.03.2021 parashtron ankesë në OSHP, dhe sipas vendimit te Panelit Shqyrtues nr. 240/21 të datës 25.03.2021 kërkohet rivlerësim i aktiviteti të prokurimit.
- Edhe pse Paneli Shqyrtues lëshon vendim për rivlerësim AK përsëri me datë 28.04.2021 nxjerr vendim ku përsëri për kontratë rekomandon OE "Meditech"
- Me date 30.04.2021 OE. "Pharam Leader"LLC parashtron kërkesë për rishqyrtim e cila refuzohet nga nga AK dhe si rezultat i kësaj parashtron përsëri ankesë ne OSHP për te cilën ankesë është lëshuar një ekspertizë nga eksperti shqyrtues i cili gjithashtu rekomandon qe aktiviteti i prokurimit te rivlerësohet pasi qe vlerëson se pretendimet ankimore janë të bazuara .
- Pas vendimit të OSHP-së- nr . 397/21 Autoriteti kontraktues me datë 12.08.2022 publikon njoftimin mbi vendimi e AK për anulim të aktivitet të prokurimit.
- OE "Pharma Leader" kundër këtij vendimi me datë 16.07.2022 parashtron kërkesë për rishqyrtim Gjithashtu OE "Meditech " me datë 17.08.2022 parashtron kërkese për rishqyrtim tek AK
- Kërkesat e parashtruar për rishqyrtim nga an e AK-së konsiderohen si kërkesa si të pabazuar dhe dhe sipas njoftimit mbetet në fuqi vendimi për anulim te aktivitet të prokurimit.
- Operatoret Ekonomik të lartcekur me date 26 dhe 29 gusht parashtroj ankesa ne OSHP me nr protokolli 397dhe 409/22

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE ANKUES

Shkeljet e pretenduara nga OE "Pharma Leader" janë si ne vijim
Neni 1, 6, 7, 52, 59, 60, 62, 69,105,108/A dhe 131 te LPP-së.
Neni 43 dhe 44, të RRUOPP-
Vendimi PSH.Nr.240/21 të dt.25.03.2021
Ekspertiza Nr.397/21 dt.31.05.2021.
Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2014, për Thjeshtësimin e Procedurave të Regjistrimit dhe Importit të Produkteve Medicinale.

1.

2. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datën 16.08.2022, kemi parashtruar kërkese për ri shqyrtim te vendimit sipas nenit 108/A, te LPP-se, përkundër faktit se AK, sipas paragrafit 9, te nenit 108/A", Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë...".
AK- MSH, me datën 19.08.2022, lëshon njoftim (jo vendim) dhe nuk trajton asnjërin nga pretendimet tona ankimore por thirret ne vendimin e OSHP-se, te dates 25.07.2022, me nr. 397/21, ku vendimi i njëjtë askund nuk kërkon anulimin e aktivitetit te prokurimit

Pretendimi nr 1 Me datën 12.08.2022, kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit, ku AK-MSH, ka propozuar anulimin_e_aktivitetit_te_prokurimit_"Furnizim_me_Insulina_Anloge_nga_Lista_Esenciale"_me_Nr.te prokurimit 206-20-8397-1-1-1, për Lot 1 dhe Lot 3. AK edhe përmes këtij njoftimi përsëri, shkel dispozitat e LPP-se si dhe parimet kryesore te prokurimit publik.

Ne te njëjtin vendim ne njërën ane si arsyetim te anulimit te procedurës AK, është bazuar ne nenin 1 dhe nenin 6 te LPP-se, per shfrytëzim te drejte te fondeve dhe burimeve publike, ne anën tjetër i është referuar çmimit te ofertës e cila ka qene me e larte se oferta e jone ne Lotet 1 dhe 3 ku ka theksuar "OE / rekomanduar për kontrate ne vitin 2021, per Lot 1 te këtij aktivitetit te prokurimit ka qene me çmim per njësi 4.36 Euro, ndërsa kontrata e fundit qe ju si AK keni lidhur me te njëjtin OE ka qene 4.25 Euro, ndërsa ne Lot 3 po ashtu çmimi i ofertës me te njëjtin OE ka qene 4.74 Euro, ndërsa kontrata e fundit e negociuar ka qene me çmim 4.60 Euro për njësi.
Përkundrazi AK- MSH, fare mire ka qene ne dijeni se per kete aktivitet te prokurimit ne vlerësimin e komisionit të parë te ofertave dhe ne Njoftimin mbi vendimin e AK ne si kompani jemi shpallur te përgjegjshëm ne Lot 1 me çmimin per njësi 4.18 Euro, ndërsa ne Lot 3 me çmim për njësi prej 4.37 Euro. (shiqo procesverbalin e hapjes se ofertave 05.01.2021 si dhe raportin e vlerësimit te ofertave te datës 08.02.2021 dhe Njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës. 22.01.2021 Provë.

Nga analiza e mësipërme e çmimeve, kuptohet qartë se ne kemi çmimin më të ulët në krahasim me OE te rekomanduar për kontratë MEDITECH dhe në krahasim edhe me kontratën e nënshkruar, të cilës i është referuar Autoriteti Kontraktues(e cila nuk është palë në këtë procedurë)

Krahasimi është bërë me kontratën e lidhur me procedurë të negociuar me te njëjtin operator ekonomik pasi linda jonë per një kohë të gjatë mbeti ne OSHP, i njëjti AK e ka ftuar vetëm ofertuesin MEDITECH dhe është lidhë kontrate sipas kësaj procedure dhe neve fare nuk na kanë ftuar ne ketë aktivitet prokurimi edhe pse disa here ne mënyre zyrtare përmes e-mailave dhe kërkesave te protokuluara kemi kërkuar dhe njoftuar AK-MSH se i posedojmë Insulinat e kërkuara ne Depon tone farmaceutike te gateshe per dorezim brenda ditës (provë)

Vlenë te theksohet se edhe kjo kontratë nëse krahasohet me çmimin e ofruar nga ana jonë është shumë me çmim ma te lart se sa qe ne e kemi ofruar çmimin në ketë aktivitet te prokurimit dmth edhe ky tentim arsyetimi nuk qëndron qe dmth. se AK duke e neglizhuar këtë aktivitet te prokurimit ka arritur prap te lidhë kontratë te kundërligjshme me OE e tij të preferuar dmth veq është dëmtuar buxheti AK me veprime te kundër ligjshme.

Prandaj nisur nga këto analiza dhe përshkrime që i bëmë, AK-ja është dashur të vazhdojë me procedurën e prokurimit dhe të na rekomandonin neve për kontratë, nëse më të vërtetë e kanë pasur qëllimin që të respektohen neni 1 dhe 6 i LPP-së.

Sa i përket analizës që i ka bërë AK-ja ndërmjet çmimit të OE të rekomanduar për kontratë MEDITECH dhe kontratës aktuale, e ka cekur që diferenca në çmim për dy Lotet është 160, 519.36€,është bërë vetem sa per tu arsyetuar dhe anuluar kete aktivitet te prokurimit per keto dy Lote dhe për te favorizuar OE te rekomanduar për kontrate. Pra për te ja mundësuar edhe njëherë tenderimin dhe nuk kane bërë asnjë krahasim me ofertën tonë me qëllimin e vetëm për te amnistuar veten dhe AK-MSH nga shkeljet e vazhdueshme te FDT-se dhe LPP-se.

Ndërsa per sqarimin tuaj nëse analizohet çmimi ofertues i yni në total, me çmimin e OE të rekomanduar për kontratë MEDITECH, diferenca rezulton të jetë rreth 400,000.00 euro, kurse nëse krahasohet me kontratën aktuale rezulton të jetë 240, 000.00 €.

Pra, nëse do të ishte analizuar çmimi që nga fillimi, dhe nëse do të ishte marr parasysh neni 1 dhe 6, atëherë ne do të kishim nënshkruar kontratë që moti dhe nuk do të kishte ardhur situata deri këtu me shkelje të vazhdueshme te ligjeve te LPP dhe FDT-së

Per procedurën e prokurimit: "Furnizim me Insulina Analoge nga lista esenciale" Loti 1 dhe 3, me numër te prokurimit 206-20-8397-111, ne si operator ekonomik i pergjegjeshem, sipas kerkesave te percaktuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim per kontrate, tani me kemi konfirmimin edhe permes organit pergjegjes per prokurim publik sic eshte OSHP, ku përmes vendimit te dates 25.03.2021, jemi shpallur si operator i përgjegjshëm dhe AK - MSH, është obliguar qe pas Ri vlerësimit te ofertave te na Ri rekomandon për kontrate sipas vlerësimit te ofertave. Per kundër ketij fakti, AK ka shkelur dispozitat e nenit 105, te LPP-se, duke mos respektuar vendimin e Panelit Shqyrtues 240/2021. (Shiqo vendimin e PSH-se nr, 240/2021, te dates 25.03.2021).

Eshtë me rendësi te theksohet fakti se AK - MSH, pas kerkeses per ri shqyrtim te datës 26.02.2021, te OE "Meditech",me nxitim e aprovojne kërkesën si te bazuar, duke u mbështetur ne pretendime ankimore te cilat i referohen interpretimeve te pa verteta-shpifjeve, per kunder faktit se AK-MSH, paraprakisht te gjitha pretendimet ankimore te "Meditech", i ka trajtuar dhe verifikuar zyrtarisht dhe nje gje te tille ne raportin e vleresimit paraprak te ofertave e ka konstatuar dhe bashkangjitur ne plotesimin e raportit.

AK, permes aprovimit te pretendimeve te pavërteta-shpifjeve te cilat veq se i ka pasur te verifikueshme, lenden e kthen ne ri-vlersim dhe e rekomandon per kontrate OE ankues ne kohe rekorde pa u konsultuar fare

me komisionin paraprak dhe pa kerkuar informacione shtese per te arsyetuar vendimin e marre ne kundershtim me vendimin e meparshem te aprovuar nga vete AK-MSH.

Kete shkelje te FDT dhe LPP-se te pretenduar ne Kerkesen tone per rishqyrtim e cila refuzohet nga AK MSH si e pabazuar e konstaton edhe eksperti dhe paneli shqyrtues i OSHP-se ku kan konstatuar se pretendimet tona ankimore jane te bazuara ne te gjitha aspektet sa i perket Lotit 1 dhe Lotit 3 (Vendimi i PSH-se nr, 240/2021, te dates 25.03.2021.

AK- zyrtaret përgjegjës te prokurimit, kane qene dashur te jene te vetedijshem se te pavertetat-shpifja është e dënueshme sipas ligjeve tjera ne fuqi, por qud itrisht behet pjese e tyre kundrejte kompanise tone te cilat ne si OE pas vendimarrjes se kesaj procedure te prokurimit, do ti raportojme ne organet tjera kompetente pasi qe imazhi i kompanisë tone dhe prodhuesit ne vazhdimësi tentohet te njolloset

Pretnedimi 3 Per kundër kësejë ne përsëri e kemi kontestuar Ri vlerësimin dhe shkeljet e AK-se, ku përkundër vendimit te Panelit Shqyrtues të OSHP-së, oferten ton e trajton si te pa pergjegjeshme me arsyetimin e njejtë pa asnjë argument shtesë, prandaj ne ri vleresimin e ofertave perseri e kemi kontestuar ne OSHP.dhe me dt 31.05.2021, kemi pranuar raportin e dyte te ekspertizes me nr 397/21, ku pretendimet tona ankimore jane rilegjitimuar dhe përgjegjshmëria e ofertës tone per dy Lotet eshte rikonstatuar. (shiqo raportin e ekspertit shqyrtues te dates 31.05.2021, me nr. 397/21.

Pavarësisht këtyre fakteve AK - MSH, nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP dhe mendimet e eksperteve, keto veprime te AK-se behen qëllimisht meqë OSHP, ne ketë kohe ka mbetur pa bord funksional, pra AK - MSH, ne menyre te kundërligjshme duke e shfrytezuar situatën ne OSHP qe kishte mbetur pa bord dhe ! ishin te vetëdijshëm se nuk ka kush te merr masa ndaj AK- MSH, perseri nuk e perfillin vendimin e OSHP te dates 25.03.2021, por ne mënyre te kundërligjshme e ka shpallur fitues OE i cili ishte gati gjysmë milioni euro me i shtrenjtë, AK- MSH, per kundër këtij fakti ka vazhduar me shkelje dhe pretendon ne vazhdimësi ta anulon Lotin 1 dhe Lot 3, per te amnistuar veprimet veta kundërligjore te kësaj procedure te prokurimit, me qëllimin e vetëm qe te procedon me tej dhe te negocioj kontratë te re me operatorin ekonomik "Meditech" kompani e cila favorizohet nga AK - MSH, kohe te gjate. Pra qëllimi i AK-se edhe tani është qe pas anulimit te kësaj procedure te prokurimit përsëri te negocioj kontratë te re me kompaninë e njëjtë dhe te vazhdohet me shkelje ligjore dhe keqpërdorim te paras publike.

Pra AK, pas pezullimit te kësaj procedure te prokurimit, kontrakton ne mënyrë te paligjshme duke e dëmtuar rende buxhetin e MSH-se, Furnizim me Insulina Analoge permes UNOPS (ne dy raste) dhe nje procedure te negociuar pa publikim te kontratës ne kundërshtim me nenin 35 te LPP-se, paragrafi 2.1pika.

(iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të venfikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtnmin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose fëshimeve të autoritetit kontraktues.

Pra AK - MSH, sipas veprimeve kundërligjore dhe neglizhente te qellimshme i ka shkaktuar dem material buxhetit te Republikes se Kosoves me shum se gjysem milioni euro dhe te gjitha keto pasoja i atribohen vet AK - MSH. Edhe KRPP, me daten 21.06.2022, ka nxjerr njoftim me numer. 51/22, ku pergjegjesin per veprime kundërligjore e barte tek AK (siqo njoftimin nr. 51/22, te dates 21.06.2022.

Bazuar në arsyet, faktet dhe argumentet e theksuara më lartë jemi të bindur se Ekzaminimi, rivlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse oferta jonë është në harmoni me te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe me DT, ku kompania jone sipas vleresimit te pare eshte shpallur si e përgjegjshme dhe me çmimin me te lire te ofertave (krahaso cmimin e ofertës tone me çmimet e kontratave te negociuara) ku ne ishim ofertuesi me çmim ma te lirë siq ishte përcaktuar edhe kriteri i dhenjes "çmimi me i ulet.

Pretendim nr 4 Ne përmes procedurës se hapur, jemi shpallur si te përgjegjshëm dhe çmimi i ofertes tone per te dy Lotet ka qene rreth 400,000.00 Euro me i lire. Ne si kompani jemi ne proces e sipër te analizave financiare për procedure te hapur ne raport me ato te negociuara te lidhura nga AK- MSH, ku demet financiare rezultojnë te jen tejet te larta, si rezultat i çmimeve te ofertave te negociuar dhe kontratave te lidhura nga AK, përmes marrëveshjeve - memorandumeve me UNOPS.

Demet financiare te shkaktuara kundër buxhetit te Republikës se Kosovës te cilat me rastin e përfundimit te kontratave te negociuara do t'i deklarojmë ne organet tjera ligjezbatuese, ku kete qeshtje AK-MSH, përmes njoftimit te datës 12.08.2022, edhe vetë e ka konfirmuar se çmimi i ofertës se negociuar është dukshëm me i larte se çmimi jone i ofruar ne procedura te hapur.

Pretendimi nr 5 Ne si OE, pale e interesuar, sipas nenit 4, paragrafi 1.26 te LPP-se, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, qe ndaj zyrtareve pergjegjes te Ministrise se Shendetsise, që të marrë masa per te parandaluar shkeljet ligjore dhe keqperdorimin e paras publike. Ne perseri kërkojmë qe te zbatohen ne menyre te drejte dispozitat ligjore per prokurim publik ne fuqi te nxirret vendim dhe te urdherohet AK qe kompanin tone ta shpalle si te përgjegjshme sipas vlerësimit te ofertave ku është konstatuar edhe nga organet tjera përgjegjëse, per zbatim te legjislacionit qe nderlidhet me produktet tona te ofertuara dhe ku eshte konstatuar se te njëjtat produkte i plotësojnë te gjitha kushtet per përdorim si dhe te gjitha kriteret e kualifikimit te aplikuara ne dosje te tenderit dhe njoftimit per kontratë..

AK - MSH, dhe zyrtaret përgjegjës te prokurimit pergjat vlerësimit te ofertave kane kerkuar dhe kane marre konfirmim nga AKPPM - Agjensioni pergjegjes per produkte dhe pajisje medicinale, qe produktet tona mund te importohen dhe te tregtohen gje qe eshte vertetuar edhe me leshimin e Lejeve te Importit, bazuar ne kete ne kemi importuardhe furnizojme edhe ne keto momente disa spitale private, gjithemone sipas procedurave dhe legjislacionit ne fuqi

Pretendim nr 6 Per kundër këtij fakti AK - MSH, kokretisht zyrtari i njejt përgjegjës per prokurim i cili ka rekomanduar ofertën ton per dhënie te kontrates sipas vlerësimit te ofertave, i njejti zyrtar, oferten tone e eliminon me arsyetimin se ne si kompani "nuk e kemi te regjistruar barin - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.

Pra edhe pas Ri vlerësimit te ofertave AK ka shkelur dispozitat e nenit 52.3, te LPP-se ku ka dhene arsyetimin e njejte te eliminimit pa argumente shtese perkunder konstatimit te OSHP-së se vendimi AK- MSHj eshte ne kundershtim me kerkesat e dosjes se tenderit, "Vetëm kriteret e matëshme dhe të ciiat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim.

AK- MSH, përveç qe nuk ka respektuar dispozitat e LPP-se dhe kerkesat e aplikuara ne dosje te tenderit, nuk ka zbatuar ligjet tjera ne fuqi dhe nuk ka respektuar institucionet kompetente siq eshte Agjencioni per Produkte dhe Paisje Medicinale-pergjegjes per Leje Importi per produkte dhe pajisje medicinale,Organin Shqyrtues te Prokurimit-organi me i lartë i prokurimit dhe Dogana e Kosovës e cila për te aprovuar importin e

produkteve medicinale domosdoshmërish produkti duhet te posedoj Lejen e Importit lëshuar nga AKPPM.

Te kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional AK - MSH, ka kërkuar.

Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02/2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.

DESHMIA

Autorizimi për Marketing ne Kosovë, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paraiele të regjistruar në Kosovë vlenë UA 02 2014 dhe per dëshmi - Kopja e Certificatës se Autorizim Marketingut ne një vend te BE (si dëshmi se produkti qarkullon ne BE).

Ekspertit shqyrtues i kërkojmë me vëmendje ta analizojë kriterin 9.1 dhe 9.2 të FDT-së e potencuar më larte dhe ta analizojë se sa me dinakëri AK MSH tenton ti shmanget kriterit të paraparë pas kerkeses tonë për rishqyrtim të datës 10.03.2021 me përgjigjeje ne vendimin e AK të dates 12.03.2021 ne faqen 6 të vendimit shih si e devijon kriterin shihë përgjigje jen citojë: Pjesa e parë e kriterit të tenderit është „Kerkohet regjistrimi i barit -autorizim për marketing nga AKPPM" ku prioritet kanë produktet që janë të regjistruara në Republiken e Kosovës,krahasuar me produktet që nuk janë të regjistruara.

Pretendim nr 7 Perkunder faktit se rivleresimi i ofertave eshte bere ne kundershtim me dispozitat e nenit 59, te LPP-se dhe vendimit te OSHP-se, Udhezimi Administrativ, 02-2014, per thjeshtesimin e procedurave per regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kan paralele te regjistruara ne RKS, i cili edhe tani por edhe ne kohen e inicimit te ketij aktiviteti te prokurimit ka qene ne fuqi,ne nenin 2.5 percaktohet qartë:'Baza për vendimmarrje në përputhje me këtë Udhëzim administrativ do të jetë lista e produkteve të regjistruara në AKPPM, në bazë të nivelit 5 të kodit ATC dhe formës farmaceutike.
Niveli i 5-të sipas OBSH-së e cila përcakton kategoritë e ATC kodeve, përcaktohet në bazë të origjinës së produkteve. Produkti me te cilin kompania jone ka ofertuar LISPRO ka ATC kodin A10AB04 dhe bazë për prodhimin e kësaj Insuline është bakteria Escheria Coli me teknologjinë rekombinante të ADN-së, kurse produkti i ofertuar nga OE tjeter ASPART ka ATC kodin A10AD05 dhe bazë për prodhimin e kësaj insuline është këpurdha Saccharomyces cerevisiae me teknologjinë rekombinante të ADN-së. Këto insulina nuk janë të njëjta dhe janë pa paralele në mes veti e tregon edhe fakti se përpos origjinës, këto dy produkte-lloje të insulinave dallojnë edhe nga përmbajtja e aminoacideve në strukturën e tyre kimike. Insulina LISPRO bëhet duke ndërruar sekuencën e dy aminoacideve në zinxhirin beta: Prolina në B-28 ndërrohet me Lizinen me B-29, kurse insulina ASPART ka një zëvendësim të vetëm të prolinës për acidin asparik në pozicionin e 28 të zinxhirit B.
Duke u bazuar në sqarimet e lartëcekura kuptohet se për shkak të origjinës shumë të ndryshme të prodhimit dhe dallimit shumë të madh që kanë ndërmjet veti (njëra bakterie e tjetra këpurdhë) dhe strukturës kimike të ndryshme, atëherë kuptohet qartë që këto dy produkte edhe pse e kanë qëllimin e njëjtë -trajtimin e diabetit tip 1 dhe 2, këto produkte nuk janë të njëjta dhe me këtë rast rezulton dhe kuptohet se produkti LISPRO i ofruar nga ne, nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë.
Sa për sqarim, ATC kodi i një produkti flet për grupin terapeutik dhe përmbajtjen e produktit, e ku përmbajtja e dy produkteve u sqarua më lartë.

Ndërsa sa ai përket formës farmaceutike e cila përmendet tek UA 02/2014, në këtë rast nuk është precizuar se produkti duhet ta ketë formën e njëjtë apo të ndryshme për tu cilësuar si pa paralele, por sa për sqarimin tuaj të dy OE kanë ofruar dy përkatësisht tre lloje të insulinave të cilat kanë formë të njëjtë | farmaceutike, por veprimin e ndryshëm dhe ATC kodin e ndryshëm, varësisht nga përmbajtja dhe veprimi. Prandaj konkiudojme se nuk është forma farmaceutike karakteristika që e përcakton dallimin e produktit por është përmbajlja dhe veprimi i produktit. Shiqo dëshmitë nga OBSH-ja përsqarimin e ATC kodeve dhe sqarimevë që ne i paraqitëm më fartë. Poashtu bashkangjitur gjeni komunikimet e dt. 03.02.2021 dhe 05.02.2021.
Produkti i ofruar nga ne është në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, e po ashtu ky produkt i ka kaluar të gjitha filtrat e regjistrimit në dy Institucionet/Agjensionet më relevante ndërkombëtare/botërore siç janë EMA (Europian Medicines Agency) dhe FDA (Food and Drug Agency), fakt i cili tregon dhe flet për kualitetin dhe cilësin e lartë të këtij produkti, produkt i cili eshte ne perdorim ne SHBA,BE dhe nga me shumë se 150 vende te botes.
Pra AK - MSH, me rastin e anulimit te aktivitetit te prokurimit, perveq qe kane shkelur nenin 62, kane shkelur edhe dispozitat e nenit 44,1 te RRUOPP-se.
Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do te publikoj Formularin B58 'Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" ku paraqften arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë

Gjithashtu OE. "PHARMA LEADER"LLC permes informatave shtesp qe ka dorëzuar ne OSHP pretendimet si ne vijim:
Kompania jone sipas nenit 109, te LPP-se me datën 26.08.2022, parashtrojmë ankesë ne Organin Shqyrtues te Prokurimit, por çuditërisht pas te gjitha këtyre veprimeve AK - MSH, me datën 02.09.2022, nxjerr vendim tjetër (përkundër faktit se me daten 18.08.2022 perzullon aktivitetin e prokurimit) dhe përsëri refuzon kërkesën tone si te pa bazuar me qëllimin e vetem amnistimin e shkeljeve zingjirore dhe esenciale te dispozitave ligjore dhe nenligjore te LPP-se.

Rregullat për parashtrim te kërkesës për ri shqyrtim neni 6, percakton " parashtrimi I kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe ne ketë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës I Prokurimit, duhet te njoftoj me shkrim te gjitha palët e interesuara lidhur me pezullimin e procedurës se prokurimit ne fjale.
AK- Ministria e Shëndetësisë, per këte procedurë te prokurimit dhe zyrtaret përgjegjës te saje po thuaja se per çdo veprim te ndërmarr bëjnë shkelje ligjore, konkretisht edhe me daten 28.08.2022, nxjerr vendim perseri per pezullim te aktivitetit te prokurimit pas parashtrimit tone te ankese ne OSHP.

Po ashtu e njoftoje Organin Shqyrtues te Prokurimit, se OE "Meditech" e ka parashtruar Kërkes ëpër Rishqyrtim me datën 17.08.2022, përderisa njoftimi i Autoritetit Kontraktues për anulim te aktivitetit te prokurimit është bërëme datën 12.08.2022, qe rezulton sekërkesa për ri shqyrtim e OE "MEDITECH" është dorëzuar jashtë afatit ligjor.

Pra Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, detyrimisht është dashur qe kerkesen e njejte ta hudh si te jashte afatshme, prandaj kërkojmë nga OSHP- Eksperti shqyrtues dhe Paneli shqyrtues qe ankesën e OE Meditech shpk, ta hudhe posht sit e jashte afatshme.

D
ispozitate nenit 112, te LPP-se, par 1 percaktojne : " Përveç nëse paneli përkatës shqyrtues nxjerr një vendim tjetër me shkrim dhe përderisa ta nxjerrë këtë vendim, dorëzimi i një ankese e obligon autoritetin kontraktues që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa në fjalë

Pretendimet ankimore te OE "Meditech".

Neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi - përcakton që AK nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në atë mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të OE, ose që diskriminon në dëm ose në të mire të një ose më shumë OE. Konfimimi i anulimit të aktivitetit të prokurimit në rastin konkret, përmes një arsyetimi tërësisht të paqëndrueshëm, lë dyshime për diskriminim në dëm të OE MEDITECH.
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës - përcakton se, që një tender të mund të shpërblehet me kontratë, ai duhet të jetë tender i përgjegjshëm - që plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit, dhe të jetë tenderi me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme. Meditech i ka plotësuar të gjitha kërkesat e tenderit, dhe rrjedhimisht ka qenë detyrim i AK të shpërblejë me Kontratë.
Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit - AK mund të anulojë/përfundojë aktivitetin e prokurimit në rast se: të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; ka ndodhur ndonjë shkelje ligjore; apo kur një gjë e tillë është bërë e nevojshme, para hapjes së tenderëve, për shkak të ngjarjeve objektive jashtë kontrollit të AK.
Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve - përmes pikës 3.3 të paragrafit 3 të saj qartëson faktin se anulimi i aktiviteteve të prokurimit bëhet përmes një vendimi.
1. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet.

Kjo Ankesë dorëzohet në përputhje me Nenin 109 të LPP-së, në raport me Njoftimin e AK për vërtetim të Njoftimit për Anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë - të dy këto njoftime të marra në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

Anulimin e aktivitetit të prokurimit AK e ka arsyetuar kinse për arsye të ndryshimit/uljes së çmimeve në treg. Kjo përkundër që: së pari, OSHP i ka dhënë të drejtë AK-së që ta nënshkruajë_kontratën_për_aktivitetin_e prokurimit_në_fjalë,_sipas_çmimeve_të_ofertuara;_dhe, së dyti, çmimet e ofertës së përzgjedhur për kontratë janë në përputhje me çmimet aktuale të tregut.

Pra, përkundër se AK-së i është lejuar nënshkrimi i kontratës me OE MEDITECH, AK ka vendosur që të mos e nënshkruajë kontratën dhe që, në mënyrë kundërligjore, ta anulojë aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Për më tepër, AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në fjalë përmes një njoftimi, përkundër që dispozitat ligjore në fuqi përcaktojnë që anulimi duhet të bëhet përmes një vendimi.

Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me ligjin në fuqi

LPP përcakton që anulimi i një aktiviteti të prokurimit duhet të bëhet përmes një vendimi - e jo përmes një njoftimi siç është rastin konkret .

Sipas LPP-së, anulimi i aktiviteteve të prokurimit duhet bëhet përmes vendimeve që lëshohen nga AK. Pas

vendimeve për anulim, kuptohet, lëshohen edhe njoftimet për ato vendime. Në anën tjetër, në rastin konkret, AK, pa marrë (apo publikuar) një vendim, ka publikuar një njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Kështu, Neni 108/A i LPP-së së konsoliduar, në paragrafin 3, pikën 3.3, të tij, përcakton si vijon:

2. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme.

3. 3. Në qoftë se shkelja ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

Dispozita e lartcekur qartëson faktin se anulimi i një aktiviteti të prokurimit bëhet përmes një vendimi, i cili - vendim - bëhet publik dhe, rrjedhimisht, hyn në fuqi, përmes njoftimit për anulim.

Se anulimi duhet të bëhet përmes një vendimi, e jo përmes një njoftimi, në mënyrë indirekte, konfirmohet edhe nga vetë AK. Kështu, në njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, në pjesën "lënda/tema", AK ka shënuar si vijon: Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Përmes kësaj fjalie, përkatësisht ketij emërtimi, AK ka bërë të qartë se akti i lëshuar është vetëm një njoftim, për të cilin - njoftim - duhet të ekzistojë edhe një vendim. Përkundër kësaj, AK nuk ka marrë fare vendim:

Arsyetimi i përdorur nga AK për anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë është tërësisht i pabazuar dhe nuk përkon me kushtet ligjore që kërkohen të plotësohen në mënyrë që të lejohet anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë. Shkaqet për të cilat mund të përfundohet/anulohet një aktivitet i prokurimit, janë përcaktuar në Nenin 62 të LPP-së, si në vijim:

"1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit..

1.2 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
1.3 para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontaktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Në rastin konkret rezulton se nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet e mësipërme. Përkundër kësaj, AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin kinse për shkak të "ndryshimit gjendj së çmimeve në treg". Arsyetimi i dhënë nga AK për anulim të aktivitetit të prokurimit nuk paraqet bazë ligjore sipas të cilës mund të anulohet një aktivitet i prokurimit.

Rrjedhimisht, rezulton se duhet ë anulohet si i kundërligjshëm njoftimi përmes të cilit është anuluar aktiviteti i prokurimit në fjalë. Anulimi i vendimit të AK do të ndikonte që, fillimisht, të mos shkelet ligji i aplikueshëm në fuqi, që të realizohet synimi për të cilin AK ka hapur aktivitetin e prokurimit në fjalë, dhe që të mos dëmtohen OE MEDITECH, buxheti i AK, e as shëndeti i qytetarëve të Kosovës në instancë të fundit.

PRETENDIMIANKIMOR 2

OSHP i ka dhënë te drejtë AK që ta nënshkruajë Kontratën për aktivitetin e prokurimit në fjalë

AK, përmes Vendimit dhe Njoftimit për dhënie të kontratës, ka shpërblyer me kontratë OE MEDITECH për këtë aktivitet të prokurimit. Kundër vendimit të tillë të AK, OE i pakënaqur Pharma Leader L.L.C. ka paraqitur ankesë në OSHP.

Përmes Vendimit Psh.nr.397/21, të datës 12.07.2022, OSHP ka hedhur poshtë si të jashtë- afatshme ankesën e OE në fjalë, duke lënë kështu në fuqi Vendimin e AK për shpërblim të OE "MEDITECH.

Pra, përmes Vendimit të datës 12.07.2022, OSHP realisht i ka dhënë drejtë AK që të nënshkruajë kontratën për aktivitetin e prokurimit në fjalë, me OE MEDITECH. Përkundër kësaj, AK ka vendosur të mos-shfrytëzojë një të drejtë të tillë me një pretendim tërësisht të paqëndrueshëm - kinse për shkak të ndryshimit të çmimeve në treg.

Refuzimi i AK për nënshkrim të kontratës dhe anulimi i aktivitetit të prokurimit nga i njëjti - AK - rrezikon të shkaktojë pasoja serioze jo vetëm për buxhetin e shtetit, por edhe për shëndetin publik të qytetarëve, përkatësisht pacientëve, të vendit. Kjo pasi që produktet që janë kërkuarpër Lot 1 dhe 3, përmes këtij aktiviteti të prokurimit, janë me rëndësi esenciale për trajtimin e pacientëve të prekur nga sëmundja e diabetit. Në anën tjetër, anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit do të çojë në (a) mos-furnizimin aktual të AK-së me produktet në fjalë dhe në (b) hapjen e aktivitetit të ri të prokurimit nga AK, me të njëjtin objekt si në rastin konkret.

Së pari, hapja e një aktiviteti të ri të prokurimit do të ketë shumë mundësi të ballafaqohet me vonesa të shumta dhe me ankesa të OE për të njëjtat arsye si në rastin konkret. Një gjë e tillë do të shkaktonte vonesa të mëdha procedurale dhe do të shtynte edhe për një kohë të gjatë furnizimin e AK-së me produktet në fjalë. Rrjedhimisht, në raste të tilla do të ekzistonte rreziku që vendi të ballafaqohet me mungesë të insulinave në treg, gjë që do të rrezikonte drejtpërsëdrejti shëndetin e pacientëve që trajtohen me këtë product.

Oferta e MEDITECH është më i lirë se buxheti i AK-së dhe është në përputhje me çmimet aktuale të tregut.

Në rastin konkret, fillimisht duhet të kemi parasysh se oferta e Meditech e zgjedhur për t'u shpërblyer me kontratë është më e lirë se buxheti i AK-së, dhe në linjë ne çmimet e tregut. Në tabelën në vijim kemi paraqitur çmimet me të cilat ka ofertuar OE MEDITECH dhe buxhetin e AK-së.

Pra, përkundër rritjes së çmimeve në treg, oferta e OE MEDITECH nuk tejkalon buxhetin e AK-së. Rijedhimisht, rezulton se ndryshimi i çmimeve në treg nuk ka ndikuar në asnjë formë në rastin konkret.

Po ashtu, fakt me shumë rëndësi është fakti që çmimi i ofertës së OE MEDITECH është në përputhje edhe me çmimet aktuale të tregut. Me inflacionin e lartë dhe rritjen e çmimeve, është e mundur që çmimet të jenë shumë me të larta në një tender të ri.

Përmes dy tenderëve paraprak, në mënyrë indirekte, vetë AK ka vlerësuar ofertën e OE MEDITECH si të vetmen ofertë të përgjegjshme.

UNOPS, agjenci e Kombeve të Bashkuara, në të kaluarën, në cilësi të autoritetit kontraktues, ka realizuar një aktivitet të prokurimit në llogari të Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht SHSKUK-së, me kërkesën për

furnizim me insulina - sikurse në aktivitetin aktual të prokurimit.

Aktiviteti i prokurimit i zhvilluar nga UNOPS identifikohet si vijon: UNOPS RFQ Ref. No.: "23179-RFQ-005- Supply and Delivery of Insulins", phase I and II (Furnizimi dhe Dorëzimi i Insulinave - faza I dhe II

Në aktivitetin e prokurimit në fjalë kanë ofertuar, ndër të tjerë, edhe OE MEDITECH dhe OE Pharma Leader. UNOPS ka shpërblyer me kontratë OE MEDITECH, për të dy fazat, pasi që ka konstatuar se është i vetmi OE i pajisur me Autorizim Marketing dhe me Certifikata dhe Analiza të prodhuesit, për produktet - insulinat - që janë kërkuar.

Ndërkaq, për OE "Pharma Leader, UNOPS ka deklaruar se, meqenëse i njëjti nuk posedon Autorizim Marketing, produktet e tij, përveç që ligjërisht nuk mund të shpërblehen me kontratë, konsiderohen edhe si tejet të rrezikshme për shëndet të pacientëve. Pra, UNOPS ka eliminuar ofertën e Pharma Leader pasi i njëjti ka ofertuar me produkte të paregjistruara dhe të importuara nga tregje të panjohura - pra, kaparaqitur ofertë të papërgjegjshme, njësoj sikurse në aktivitetin aktual të prokurimit.

Kjo duke marrë parasysh se Autorizim Marketingu është parakusht që lejon shitjen e një produkti medicinal në Kosovë dhe konsiderohet edhe si "pasaporta e barit" pasi që dëshmon kualitetin dhe origjinën e produktit që importohet. Rijedhimisht, sipas ligjit në fuqi dhe praktikës së krijuar nga vetë AK, mos-posedimi i Autorizim Marketingut nuk e lejon OE e caktuar që të shpërblehet me kontratë në një aktivitet të prokurimit.

Për më tepër, në rast të lejimit të shitjes së një produkti medicinal, pa Autorizim Marketing, kompania që plason atë produkt në treg nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi lidhur me produktin.

Si përfundim, të gjitha faktet e lartcekura dëshmojnë se pretendimi i dhënë nga AK për të anuluar aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk qëndron dhe lë dyshime për diskriminim të OE MEDITECH. Diskriminimi në dëm të OE, ndërkaq, shkelë parimin kyç sipas të cilit duhet të zhvillohen aktivitetet e prokurimit - parimin e barazisë në trajtim/jo-diskriminimin.

Për më tepër, AI< ka anuluar aktivitetin e prokurimit përmes një njoftimi, përkundër që ligji në fuqi përcakton që anulimi duhet të bëhet përmes një vendimi.

Prandaj, bazuar në argumentet dhe shkeljet e elaboruara si më lart, OE MEDITECH, kërkon nga OSHP që, pas shqyrtimit meritor të rastit, të merr këtë.

APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik MEDITECH SH.P.K.

ANULOHET Njoftimi i Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, i datës 19.08.2022, i lëshuar për OE MEDITECH SH.P.K., si i kundërligjshëm, dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe rivendosje.

Tabela.1 Çmimet e ofruara sipas procesverbalit të hapjes publike të datës 05.01.2021

Nr.	Tenderuesi	Pjesë Lot I Lot III	e-tenderit	Çmimi (me TVSh)	Ndryshimi/
1.	PHARMA LEADER L.L.C.. Veternik, rr. e Gjilanit p.n.,, 10000, Prishtine	loti-1	PO	1,097,4670.36	JO
2.	PHARMA LEADER L.L.C.. Veternik, rr. e Gjilanit p.n.,, 10000, Prishtine	loti-3	PO	4,109,006.12	JO
3.	MEDITECH, e Livadhit Çagllavicë. 10000, PRISHTINË	loti-1	PO	1,144,726.72	JO
4.	MEDITECH, e Livadhit Çagllavicë. 10000, PRISHTINË	loti-3	PO	44,569,08.24	JO

KRITERET PËR KUALIFIKIM DHE VLERËSIM

AK në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë ka parashtruar kriteret e përzgjedhjes si në vijim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Një deklarate e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.	1. Deklarata nën Betim.
2. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para publikimit të	2. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës.
3. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.	3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit.	1. Certifikata e biznesit - kopje.
2. Regjistrimi ne regjistrin Fiskal.	2. Kopje e Certifikatës se Numrit Fiskal - kopje.

3. Certifikata për TVSH për secilin partner te një grupi operatoresh ekonomik - kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove.	3. Kopje e Certifikatës se TVSH-se - kopje.
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar, për tenderin përkatës, (nëse autorizimi është nga distributori atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit) për shitjen e produkteve qe ofertoni. Autorizimi te përmbajë te dhëna te mjaftueshme te kontaktit për prodhuesin, me qëllim te verifikimit eventual	1. Autorizim nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar, per tenderin përkatës (me te dhëna mbi prodhuesin, si psh adresa, nr. tel, email, web faqja etj, për mundësi te verifikimit).
2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës	2. Autorizimi për Marketing ne Kosovë, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë vlenë UA 02 2014 dhe per dëshmi - Kopja e Certificatës se Autorizim Marketingut ne një vend te BE (si dëshmi se produkti qarkullon ne BE).
3. Te dëshmohet se OE është i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike.	3. Licenca nga AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike (me validitet) Kërkohet kopje.

Kriter për vlerësim ka qenë çmimi më i ulët i poentuar sipas tabelës në vijim:

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES.

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimim 240/21

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE-ve ANKUES

Përgjigjeje në pretendimet ankimore te OE "Pharma Leader "LLC

Pretendimet ankimore 1,2,3 dhe 4 konsiderohen pretendime të bazuara për faktin se anulimi i tenderit nga ana e AK—Ministrisë së Shëndetësisë sipas vendimit të datës 12.08.2022 është bërë ne kundërshtim me dispozitat e LPP-së konkretisht me nenin 1 dhe 6 pasi qe Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për anulim te Aktivitetit të Prokurimit nuk gjen mbështetje në depozitat e nenit 62 të LPP-së.

Arsyetimet e dhëna në Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit sipas Ekspertit Shqyrtues janë jo parimore për faktin se si arsye merret krahasimi i çmimeve me furnizues të mëhershëm [1] ku për llot I sipas AK-së çmimi i furnizimit për njësi ka qenë 4.25 Euro, ndërsa OE i rekomanduar ka ofruar çmim prej 4.36 Euro, ngjashëm është berë krahasimi edhe për Lotin III ku sipas AK-së çmimet paraprake furnizuese kanë qenë 4.60 Euro ndërsa çmimi OE te rekomanduar për kontratë është 4.74 Euro .

AK nuk e ka marrë për bazë faktin që Kompania "Pharma Leader" ofron çmim për lot I prej 4.18 Euro, dhe për llot III 4.37 Euro që ne vlerë totale ne raport me ofertën e rekomanduar dhe krahasimet e bëra dallon jashtë zakonisht shumë.

Në vendimin E Panelit Shqyrtues nr. 240/21 të datës 25.03.2021 kërkohet që aktiviteti i prokurimit te rivlerësohet për shkak se sipas vendimit e datës 05.03.2022 AK nuk ka respektuar kriteret kualifikuese dhe vlerësimi i ofertave nuk është bere ne përputhje me nenin 59 të LPP-së , pasi që sipas këtij vendimi për kontrate rekomandohet OE "Meditech" i cili ofron çmim me te lartë dhe njëkohësisht konsiderohet ofertë e përgjegjshme ..

Edhe pse vendimi i Panelit Shqyrtues kërkon rivlerësim të ofertave AK ne vendimin e datës 28.04.2021 përsëri për kontratë e rekomandon OE."Meditech" edhe përkundër qe dallimI ne çmim është afër 400 mijë Euro.
Gjithashtu lidhur me ketë vlerësim ne baze të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga OE "Pharma Leader" me datë 30.04.2021 Eksperti shqyrtues i OSHP-së lëshon ekspertizë me nr. 397/21 dherekomandon qe AK të rivlerësoj aktivitetin e prokurimit.

Lidhur me ketë aktivitet të prokurimit fillimisht nga AK-Ministria e Shëndetësisë për kontratë për Lot 1dhe 3 fillimisht ishte rekomanduar OE "Pharma Leader " ndërsa OE "Meditech " kishte rezultuar si OE i pasuksesshëm pasi qe çmimi tij ka qenë shumë më i lartë në raport me OE të rekomanduar pasi kriter për vlerësim ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulet.

Pas kërkesës së parashtruar për rishqyrtim nga ana e OE "Meditech" AK ndryshon vendimin dhe tani për kontratë rekomandon OE" Meditech" ndërsa OE."Pharma Leader"e kualifikon të papërgjegjshëm.

[1] Nuk dihet s e për çfarë kontratash behet fjale dhe ato kontrata nuk mund të jenë okjet trajtimi nga Eksperti Shqyrtues

Sipas rivlerësimit të datës 26.02.2021 ku për kontratë rekomandohet OE "Meditech" edhe pse sipas vendimit të Panelit Shqyrtues nr. 240/21 të datës 25.03.2021 dhe ekspertizës e ekspertit shqyrtues nr. 397/21 të datës 31.305.2021 konsiderohet jo i drejtë dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së

Fakti qe AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së nr240/21 konsiderohet shkelje e nenit 105 të LPP-së sepse vendimet e Paneleve Shqyrtuese janë detyruese për palët .

Vlerësimet dhe konstatime e eksperteve dhe njëkohësisht vendimi i Panelit Shqyrtues janë injoruar nga ana e Autoritetit kontraktues për faktin se për kontrate AK ka rekomanduar OE me çmim me të e lartë përkundrejt OE me çmim me te lire i cili fillimisht ka qenë i rekomanduar për kontratë ndërsa me vonë rezulton si OE i papërgjegjshëm

Pretendim nr. 5 dhe 6 konsiderohet i bazuar për arsye se OE" Pharma Leader" i ka plotësuar kriteret kualifikuese qe kanë të bëjnë me nenin 69 të LPP-së pasi q ë dosje te tenderit kërkesa ka qenë si në vijim: *Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlen UA 02/2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.*

Sipas vlerësimeve nëse OE nuk ka Autorizim për Marketing të lëshuar nga AKPPM do të thotë se i lejohet mundësia qe përmes UA 02/2014 të bëj importin produkteve medicionale për ato produkte e që nuk kanë paralele ne Kosovë .

Lidhur me ketë çështje zyrtaret e Autoritetit Kontraktues kanë kërkuar sqarim nga AKPPM dhe ne bazë te përgjigjeve konkrete ka rezultuar qe produktet e ofruara OE "Pharam Leader" nik kanë paralele dhe si të tilla mund ti nënshtrohen UA 02/2014 për thjeshtësim të procedurave për regjistrim dhe importim të produkteve meridionale pasi që e nuk janë produkte paralele .

Provë: komunikim mes AK-së dhe AKPPM-së

Për me teper i referoheni komunikimit ne mes AK-së dhe AKPPM të dates 05.02.2021

Operatori Ekonomik "Pharma Leader" me date 16.08.2022 parashtron kërkesë për rishqyrtime atakon njoftimin për anulim te aktivitet te prokurimit te datës 12.08.2022 dhe lidhur me ketë kërkesë AK përmes njoftimit të datës 19.08.2022 e njofton OE ankues se kërkesa e tij për rishqyrtim refuzohet si e pa bazuar dhe ne fakt nuk jap përgjigje në pretendimet ankimore

Gjithashtu OE ."Meditech" me datë 17.08.202 parashtron Kërkesë për Rishqyrtim e cila kërkesë refuzohet si e pa bazuar dhe me date 19.08.2022 njoftohet OE se mbet ne fuqi vendimi i datës 12.08.2022 për anulim te aktivitet t prokurimit

Sipas pretendimeve ankimore te parashtruara nga OE Pharma Leader " Kërkesa për Rishqyrtim" e datës 17.08.2022 e parashtruar nga "Meditech" ka qenë jashtë aftashme dhe ne kundërshtim me nenin 108/ A dhe Rregulloren për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim apo ankesave ne OSHP.

Bazuar ne nenin 108/A paragrafi 3.3 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e

procedurës së prokurimit, kërkesa për rishqyrtim tek AK duhet të behët brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktivitetit prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim në të kundërtën duhet refuzuar si te jashtë afatshme.

Gjithashtu sipas rregullore F03 Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP afatate sipas nenit 4 për paraqitje të këerkesav për rishqyrtim janë si ne vijim:

I. PARAQITJA E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM PRANË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 4

Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues

Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet te dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.

b) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te nje konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.

c) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

Eksperti konstaton se njoftimi për vendim për anulim te aktivitet te prokurimit është berë me datë 12.08.2022 ndërsa kërkesa për rishqyrtim nga OE "Meditech" është parashtruar me datë 17.08.2022 që do te thatës se Kërkesa për Rishqyrtim e pranuar dhe shqyrtuar nga AK është në kundërshtim me rregullat e cekura me lartë.

Gjithashtu AK edhe përkundër vendimit për pezullim të aktivitetit të prokurimit te marre me datë 29.08.2022 si rezultat i parashtrimit te ankesave në OSHP me datën 02.09.2022 ka marrë dy vendime dhe janë publikuar ne e-prokurim për OE të cilët kanë parashtruar ankesë dhe kjo bie ndesh me nenin 112 të Ligjit pasi qe me rastin e parashtrimit të një ankese AK ka për obligim qe të pezulloj aktivitetin e prokurimit dhe nuk ka të drejtë t ë marrë asnjë vendim me përjashtim kur kryearti apo kryetarja merr vendim për heqje të pezullimit automatik.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore të OE "Meditech" SHPK

Bazuar në dispozitat e nenit 108/ paragraf 3.3 dhe dispozitat e nenit 4 të rregullores për parashtrim te kërkesave për rishqyrtim dhe annkesave ne OSHP (F03) Kërkesa për rishqyrtim nga OE" Meditech" parashtruar me datë 17.08.2022 tek AK- Ministria e Shëndetësisë kundër njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit të publikuar me datë 12.08.2022 ne fakt ka qenë kërkesë e parashtruar jashtë afatit ligjor

Për shumë ankesa qe janë parashtruar ne OSHP nga operatoret e ekonomik që nuk i kane respektuar afatet kohore për parashtrim të Kërkesave për Rishqyrtim tek Autoritetet Kontraktues nga ana OSHP-së janë hedhur poshtë si të palejuara.

Pavarësisht kësaj Eksperti Shqyrtues vlerëson se në pretendimet ankimore për masë respektim të dispozitave të nenit 7, 60 dhe të nenit 62 të parashtruara nga OE. Meditech " konsiderohen pretendime ankimore të bazuara

Me rastin e anulimit te aktivitetit te prokurimit nuk janë plotësuar asnjëra nga nga depozitat e nenit 62 të LPP-së, por autoriteti kontraktues është thirrur ne argumentin se ka ndryshime te çmimeve ne treg dhe njëkohësisht bën një krahasim te çmimeve te ofruara nga OE "Meditech" me çmime te kontratave tjera te cilat nuk dihet se ne c`fare kushtesh apo rrethanash janë lidhur ato kontrata.

AK nuk mund te marr si pretekst për anulim të aktivitet t ë prokurmit ndryshimet e çmimeve në treg deri sa OE pjesëmarrës shprehin interesim për një aktivitet te prokurimit dhe qëndrojnë prapa çmimeve qe kane ofertuar.

Pretendimi ankimor nr 2 është jo i bazuar për faktin se OSHP ne vendimin e datës 12.07.2022 nr.397/21 nuk ka predikuar rezultatin dhe permes këtij vendimi vetëm OSHP-në e ka shpallur inkompetent për shkak se ka kaluar afti i rregullt për shqyrtim dhe trajtim të ankesave dhe përmes këtij vendimi përgjegjësia e drejtpërdrejtë është lenë tek autoriteti kontraktues.

Pretendimi ankimor nr 3 është pretendim i bazuar pasi që çmimi është brenda buxheti te përcaktuar qe do te thotë nuk ka tejkalim te buxheti të planifikuar.

Për pretendimi n ankimor nr 4 eksperti shqyrtues nuk mund të jap vlerësim pasi qe në ketë pretendim behet fjale për aktivitet tjera te prokurimit te cilat nuk janë objekt i shqyrtimi dhe nuk mund të jap vlerësim se si UNOPS i ka zhvilluar aktivitet të prokurimit pasi qe kriter vlerësim nuk mund të jetë vetëm çmimi por edhe kushte tjera te kontratës dhe njohësisht kualiteti.

Si përfundim Eksperti vlerëson se Autoritetit kontraktues duhet ta anulojnë njoftimin e datës 12.08 .2022 për anulim te aktivitet te prokurimit dhe të bëj rivlerësimin e ofertave ne përputhje me kriteret e përcaktuara për kualifikim dhe kriterin e përcaktuar për vlerësim

Mos marrja për bazë e kritereve te përcaktuara për kualifikim dhe kritereve te përcaktuara për vlerësim gjatë rivlerësimit nënkupton se AK do ti shkel parimet bazike te LPP-s siç janë konkurrenca transparenca dhe trajtimi i barabarte pasi qe mos zbatimi i këtyre parimeve nënkupton favorizim /diskriminim në favor të njërës apo tjetrës pale dhe njëkohësisht do ta dëmtoj institucionin edhe ne aspektin financiar.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Duke u bazuar në vlerësimet dhe konstatimet e lartcekura Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesat e OE ankues te aprovohen të bazuara dhe njëkohësisht propozon Autoritetit Kontraktues që të anuloj njoftimin e datës 12.08.2022 për këtë aktivitet te prokurimit dhet ë ri-vlerësoj ofertat.

Raporti ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna e Vitisë
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - “”Pharma Leader”LLC
- OE ankues = “Meditech “SHPK
-